

Dr. Fatmir Arifi

(Instituti i historisë Ali Hadri, Prishtinë)

Bio e shkurtër

Doktor i Shkencave të Historisë (Dr. Sc.): Ka mbrojtur me sukses disertacionin e doktoraturës me titull "Veprimtaria dhe filozofia e organizatave të fshehta me karakter çlirimtar në Kosovë 1945-1990". Master i Shkencave (Mr. Sc.): Studimet pasuniversitare në fushën e historisë. Fusha e Hulumtimit dhe Veprimtaria Shkencore. Ai fokusohet kryesisht në historinë moderne dhe bashkëkohore të Kosovës dhe Ballkanit, si dhe në lëvizjet ilegale çlirimtare shqiptare gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX. Projekte madhore: Është pjesë e ekipeve kërkimore të Institutit për projekte kombëtare, përfshirë grumbullimin e materialeve arkivore për projektin madhor "Historia e Kosovës". Artikuj dhe Publikime: Ka publikuar një sërë punimesh shkencore, disa prej të cilave mund t'i gjeni të indeksuara në platforma si ResearchGate - Fatmir Arifi dhe në arkivin digjital kulturor Albanica. Përfshihen punime si: The Unresolved Issues that Cross the Way to Euro-Atlantic Integrations: The Case of the Western Balkans. Qasja në dokumente publike dhe mbrojtja e të dhënave personale në Kosovë (bashkëautor). Lëvizjet politike të shekullit XX (në bashkëpunim me kolegë të Institutit).

Titulli: Kufiri si mekanizmi bipolar dhe prodhues i identitetit: Një analizë e përvojës shqiptare ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë 1944-1990.

Abstrakt

Ky studim analizon kufirin shqiptaro-jugosllav gjatë periudhës 1944-1990 si një strukturë komplekse politike, ideologjike dhe biopolitike, e cila tejkalonte funksionin klasik të delimitimit territorial dhe vepronte si mekanizëm i kontrollit shtetëror, disiplinimit shoqëror dhe prodhimit të identiteteve kolektive. Në kontekstin e Luftës së Ftohtë, kufiri ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk përfaqësonte vetëm një vijë ndarjeje gjeografike, por një hapësirë të militarizuar të mbikëqyrjes, përjashtimit dhe menaxhimit politik të popullsisë shqiptare në të dy anët e tij. Në planin teorik, studimi mbështetet në konceptin e biopolitikës të Michel Foucault, përmes të cilit kufiri interpretohet si instrument i ushtrimit të sovranitetit mbi trupin, mobilitetin dhe ekzistencën sociale të individit. Paralelisht, qasja e Maurice Halbwachs mbi kujtesën kolektive shërben për të shqyrtuar mënyrën se si përvojat e represionit kufitar, migrimin ilegal dhe dhunës shtetërore janë integruar në memorien historike dhe ndërgjegjen kolektive shqiptare. Gjithashtu, koncepti i "komuniteteve të imagjinuara" i Benedict Anderson përdoret për të analizuar ndërtimin simbolik të shtetit shqiptar si referencë identitare, me theks të veçantë "Atdheu amë" në vetëdijen politike e kulturore të shqiptarëve të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jugosllavi. Në aspektin metodologjik, punimi mbështetet në analizën ndërdisiplinore të burimeve arkivore, dëshmimeve autobiografike, materialeve të shtypit dhe dokumentacionit administrativ të kësaj periudhe. Përmes këtyre burimeve trajtohen motivet, format dhe implikimet e kalimeve ilegale të kufirit, të cilat interpretohen jo vetëm si përpjekje për t'i shpëtuar represionit politik dhe kushteve socio-

ekonomike, por edhe si forma të rezistencës politike kundër rendit të kontrolluar socialist jugosllav dhe praktikave të izolimit shtetëror. Në këtë kuptim, kufiri paraqitet njëkohësisht si hapësirë e frikës, disiplinimit dhe ndëshkimit, por edhe si hapësirë e projektimit të lirisë, shpresës dhe emancipimit kombëtar. Studimi argumenton se kufiri shqiptaro-jugosllav nuk ishte një realitet statik apo vetëm administrativ, por një proces dinamik i prodhimit dhe riprodhimit të identiteteve politike, ideologjike dhe kombëtare. Ai ndikoi drejtpërdrejt në mënyrën se si shqiptarët e konceptonin shtetin, kombin, përkatësinë dhe raportin politik dhe ideologjik me “tjetrin”, në këtë rast me Jugosllavinë. Në këtë prizëm, kufiri shfaqet si një kategori jo vetëm gjeopolitike, por edhe kulturore dhe memoriale, i cila strukturoi përvojën historike të shqiptarëve gjatë gjithë periudhës së Luftës së Ftohtë. Në përfundim, ky punim synon të kontribuojë në rikonceptualizimin e historiografisë mbi kufijtë politikë në hapësirën shqiptare, duke e zhvendosur fokusin nga dimensionin ekskluzivisht shtetëror drejt përvojës njerëzore, kujtesës kolektive dhe funksionit simbolik të kufirit. Njëkohësisht, studimi hap perspektiva të reja kërkimore në fushën e studimeve mbi biopolitikën, identitetin, kujtesën historike dhe marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në kontekstin e Luftës së Ftohtë.

Fjalë kyçe: *Kufiri, Shqipëri, Jugosllavi, biopolitikë, identitet kombëtar, shqiptarët në Jugosllavi, kujtesë kolektive, Lufta e Ftohtë, represioni kufitar.*